




NDËRTIMI I REZILIENCËS SË TË RINJVE KUNDËR AKTIVITETEVE KRIMINALE

REKOMANDIME PËR SERBINË, SHQIPËRINË DHE MALIN E ZI



BOTUESI:

Juventas

Bulevar Svetog Petra Cetinjskog 59

e-mail: info@juventas.me

PĚR BOTUESIN:

Ivana Vujović

AUTORJA:

Marica Stijepovic

DIZAJNI:

Božidarka Ćetković

VITI I BOTIMIT:

2025

Ndërtimi i reziliencës së të rinjve kundër aktiviteteve kriminale

Rekomandime për Serbinë, Shqipërinë
dhe Malin e Zi

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME	7
1.1. <i>Ndërtimi i reziliences së të rinjve ndaj aktiviteteve kriminale - rekomandime për Serbinë, Shqipërinë dhe Malin e Zi</i>	<i>7</i>
1.2. <i>Funksionojnë programet parandaluese?</i>	<i>11</i>
2. PARIMET E PRAKTIKËS.....	15
3. GRUPI I SYNUAR	17
4. VLERËSIMI - RREZIKU DHE FAKTORËT MBROJTËS.....	18
5. PJESËMARRËSIT.....	21
5.1. <i>Oficerët e policisë</i>	<i>21</i>
5.2. <i>Punonjës socialë – menaxherë rastesh.....</i>	<i>22</i>
5.3. <i>Këshillues individualë</i>	<i>24</i>
5.4. <i>Punonjës rinorë</i>	<i>26</i>
5.5. <i>Staf mjekësor</i>	<i>27</i>
6. KOMPONENTËT E PROGRAMIT	30
6.1. <i>Trajnim paraprak për profesionistë</i>	<i>30</i>
6.2. <i>Procesi i pranimit ne program.....</i>	<i>31</i>
6.3. <i>Fazat e programit.....</i>	<i>32</i>
6.4. <i>Angazhimi i familjeve</i>	<i>34</i>

7. KONSULTIME TE VAZHDUESHME, SUPERVIZIM DHE GRUPE TEKNIKE	36
8. KOORDINIMI ME SHKOLLAT	39
9. TERAPIA FAMILJARE DHE LIDHJA ME INSTITUCIONE/OJQ-TË E TJERA QË OFROJNË SHËRBIME	39
10. STRUKTURIMI I EKIPIT	40
10.1. Roli i psikiatrit	41
10.2. Roli i drejtorit/koordinatorit të programit	41
11. KOHËZGJATJA	42
12. SFIDAT	44
13. I DETYRUESHËM APO JO?	46
14. FINANCIMI	47
15. ORARI I PUNËS	48
16. KOMUNIKIM DHE RAPORTET	48
17. KONFERENCAT	48
18. OFRIMIN E KUJDESIT PAS-MBESHTETJES	49
BIBLIOGRAFIA	50



1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

1.1. NDËRTIMI I REZILIENCËS SË TË RINJVE NDAJ AKTIVITETEVE KRIMINALE - REKOMANDIME NGA SERBIA, SHQIPËRIA DHE MALI I ZI






Përfshirja e të miturve në sistemin e drejtësisë nuk është një gjendje psikiatrike, por një status i përcaktuar ligjërisht. Megjithatë, ende vazhdon debati nëse të miturit delinkuentë duhet të marrin trajtim apo ndëshkim. Edhe kur advokojmë për trajtim, jemi të vetëdijshëm se të miturit delinkuentë shpesh përfitojnë shërbime të fragmentuara, të pakoordinuara, të pamjaftueshme ose të papërshtatshme nga agjencitë ofruese të shërbimeve (Hsia & Beyer, 2000). Megjithatë, ekzistojnë të dhëna premtuese nga studimet që tregojnë se programet parandaluese ofrojnë një alternativë efektive ndaj vendosjes së të miturve në mjedise të mbyllura ose kujdes rezidencial.

Qëllimi ynë është të krijojmë një program parandalues që ofron një alternativë për Shqipërinë, Malin e Zi dhe Serbinë. Ky program është hartuar për t'iu përshtatur nevojave të sistemeve në këto vende si pjesë e aktiviteteve të projektit rajonal Ndërtimi i Reziliencës së të Rinjve Kundër Aktiviteteve Kriminale. Projekti zbatohet në bashkëpunim nga Juventas (Mali i Zi), Nisma për Ndryshim Shoqëror (Shqipëri) dhe Qendra për të Drejtat e Njeriut në Beograd (Serbi) si organizata partnere. Ai mbështetet nga iniciativa rajonale SMART Balkans: Shoqëria Civile për Shoqëri të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor, e cila zbatohet nga Centar za promociju civilnog društva (CPCD), Qendra

për Kërkim dhe Hartim Politikash (CRPM) dhe Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), me mbështetjen financiare të Ministrisë Norvegjeze të Punëve të Jashtme (NMFA).

Objektivat specifike të projektit përfshijnë, ndër të tjera, fuqizimin e kapaciteteve të policisë, klubeve sportive, gazetarëve dhe organizatave rinore për të ndërtuar reziliencë tek të rinjtë, si dhe ndërtimin e besimit midis të rinjve dhe forcave të rendit. Për zhvillimin e programit, në këto tri vende janë kryer analiza të hollësishme me qëllim hartëzimin e nevojave dhe shërbimeve për të rinjtë që janë në rrezik për t'u përfshirë në aktivitete kriminale.

Ngjashmëritë midis tre sistemeve përfshijnë:

-  Mosha e përgjegjësisë penale është vendosur 14 vjeç; megjithatë, ekzistojnë dispozita të ndryshme për të miturit në moshën 14 deri në 16 vjeç dhe 16 deri në 18 vjeç, me qasje të ndryshme ndaj ndëshkimit dhe rehabilitimit.
-  Të miturit nën moshën 14 vjeç nuk mund të mbajnë përgjegjësi penale, por mund t'i nënshtrohen masave të shërbimeve sociale në rast se përfshihen në sjellje kriminale.
-  Sistemi ligjor thekson drejtësinë restauruese për të miturit, duke u fokusuar në rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre, në vend të masave ndëshkuese. Sanksionet alternative, si shërbimi në komunitet, programet edukative dhe terapia, preferohen ndaj burgimit.
-  Rastet e të miturve trajtohen duke marrë parasysh moshën, pjekurinë dhe potencialin për rehabilitim të autorit të veprës penale. Të miturit autorë kanë të drejtë për përfaqësim ligjor, dhe rastet e tyre mund të shqyrtohen në mënyrë të veçantë nga ato të të rriturve.
-  Burgimi duhet të përdoret vetëm për krime më të rënda ose për vepra penale përsëritëse (recidivizem). Qendrat e paraburgimit për të miturit duhet të jenë të ndara nga ato për të rriturit, dhe kushtet në këto qendra duhet të jenë të projektuara për të mbështetur rehabilitimin.

Çdo sistem drejtësie për të miturit është projektuar për t'u përputhur me standardet ndërkombëtare si Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (CRC) dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat garantojnë të drejta specifike për fëmijët në konflikt me ligjin. Për shembull, neni 40, paragrafi 1, i Konventës për të Drejtat e Fëmijës parashikon se Shtetet Palë duhet të njohin "dëshirën për të promovuar riintegrimin e fëmijës dhe përfshirjen e tij në një rol konstruktiv në shoqëri".

Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit) theksojnë rëndësinë e ofrimit të faciliteteve, shërbimeve dhe ndihmave të nevojshme për të përmbushur interesin me të lartë të të miturit gjatë gjithë procesit të rehabilitimit. Ato kërkojnë që të bëhen përpjekje "për t'u siguruar të miturve, në të gjitha fazat e procedurave, ndihma të nevojshme si strehim, arsim apo trajnime profesionale, punësim apo ndonjë ndihmë tjetër të dobishme dhe praktike, në mënyrë që të lehtësohet procesi i rehabilitimit".

Duke vlerësuar rëndësinë kryesore të promovimit të mirëqenies së të miturit që ka kryer shkelje, Rregullat nënvizojnë domosdoshmërinë e ofrimit të shërbimeve dhe ndihmave që i shërbejnë interesave më të mira të të miturit gjatë gjithë procesit rehabilitues. Sipas këtyre Rregullave, qëllimi i trajnimit dhe trajtimit të ofruar të rinjve shkelës të vendosur në institucione është "ofrimi i kujdesit, mbrojtjes, arsimit dhe aftësive profesionale, me qëllim ndihmën për t'i lejuar ata të marrin role produktive në shoqëri".

Në të tre vendet, fëmijët në konflikt me ligjin duhet të mbështeten përmes një kombinimi shërbimesh të ofruara nga institucionet shtetërore dhe OJQ-të, megjithëse kapacitetet e tyre ndryshojnë.

Analiza e të rinjve në konflikt me ligjin në Mal të Zi, e kryer nga OJQ-ja Juventas (Femić, 2024) në kuadër të këtij projekti, tregoi, për shembull, se strategjia për të rinjtë 2023-2027 "tregon një angazhim

për krijimin dhe financimin e ndërhyrjeve që adresojnë nevojat unike të adoleshentëve... këto ndërhyrje janë hartuar për t'u zbatuar në nivel kombëtar dhe lokal."

Kjo analizë gjithashtu përfundon se rekomandimet kryesore për "përmirësimin e qasjes së sistemit malazez ndaj të rinjve në konflikt me ligjin përfshijnë: programe trajnimi të ndërsjellë për profesionistët; rritje kapacitetesh për profesionistët e shërbimeve ligjore dhe sociale; programin e prinderimit; si dhe rekomandimet e propozuara për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe institucional. Këta janë hapa të rëndësishëm në ndërtimin e reziliencës ndaj sjelljes kriminale brenda kësaj popullate të cënueshme.

"Analiza e të kuptuarit të nivelit të përfshirjes së të rinjve në aktivitete kriminale, si dhe faktorëve shtytës dhe tërheqës, përmes dokumenteve në dispozicion – raporti i hulumtimit të literaturës për Shqipërinë citon se në Shqipëri ekziston Strategjia për Drejtësinë për të Mitur (2022–2026), e cila promovon qasjen ndërsektoriale ndaj çdo fëmije, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të tyre, duke synuar një drejtësi sa më miqësore për secilin fëmijë.

Kjo analizë gjithashtu rekomandon forcimin dhe zgjerimin e programeve, rritjen e koordinimit midis institucioneve dhe OJQ-ve, zgjerimin e aksesit në trajnime të specializuara për profesionistët, si dhe investimin në programe parandaluese me bazë në komunitet."

Analiza "Ndërtimi i rezistencës së të rinjve ndaj aktiviteteve kriminale" nga dr. Slađana Jovanović dhe dr. Nikola Vujićić nga Serbia thekson se "kapërcimi i mangësive në sistemet e ndryshme është i domosdoshëm për të arritur qëllimet e vendimeve të ndryshme të marra për të miturit — duke përfshirë angazhimin e një numri më të madh profesionistësh dhe/ose përfshirjen e profileve specifike në sistemin e mirëqenies sociale dhe kujdesit shëndetësor, si dhe në sistemin e drejtësisë për të miturit.

Bashkëpunimi ndërsektorial ende nuk është vendosur siç duhet. Mosbashkëpunimi i prindërve dhe mungesa e kuptimit të “interetit më të lartë të fëmijës” janë shpesh probleme të theksuara, dhe puna me ta duhet të organizohet përmes programeve dhe trajnimeve të specializuara.

Masat parandaluese për të gjithë fëmijët duhet të jenë gjithëpërfshirëse, sistematike dhe të koordinuara; fëmijët nën moshën 14 vjeç nuk duhet të neglizhohen. Profesionistë të kualifikuar, të angazhuar dhe të përkushtuar duhet të përfshihen në punën me fëmijët dhe të rinjtë në konflikt me ligjin.”

Duke pasur parasysh të gjitha këto, qëllimi ynë është të krijojmë një program që i përgjigjet këtyre nevojave specifike të secilit sistem, por mbi të gjitha, nevojave të çdo fëmije.

1.2. SI FUNKSIONOJNË PROGRAMET PARANDALUESE?

Vetëm një numër i kufizuar fëmijësh dhe të rinj kryejnë vepra penale të përsëritura, por kjo grup-moshë përbën një sfidë të konsiderueshme, duke shkaktuar viktima të shumta, kërcënime dhe kosto të mëdha për shoqërinë. Prandaj, është thelbësore që ata të identifikohen që në moshë të hershme dhe t’u ofrohet kujdes adekuat, i cili parandalon zhvillimin e mëtejshëm të tendencave antisociale. Këto masa kanë një efekt të rëndësishëm parandalues dhe përmirësojnë efektivitetin e punës sociale dhe policore në fushën e parandalimit.

Gjetjet e studimit tregojnë se gjate dekadave sjellja antisociale ka shfaqur tendencë të jetë shumë e qëndrueshme. (Cummings, Iannotti dhe Zahn-Waxler, 1989), duke u shfaqur që në moshë të hershme. Vazhdimi i pandërprerë i kësaj trajektoreje me kalimin e kohës çon në manifestime gjithnjë e më serioze dhe komplekse të sjelljes antisociale. Studimet afatgjata tregojnë se që në shkollën fillore vërehet performancë e ulët akademike, shoqërim me të rinj që shfaqin sjellje shoqërisht të papranueshme dhe përdorim substancash.

Pra, mund të konkludohet se në çdo fazë të zhvillimit, prania e modeleve antisociale kufizon kalimin e suksesshëm të të rinjve në fazat pasuese, duke bërë që aftësitë e tyre për t'u përballur me kërkesat gjithnjë e më komplekse të jenë gjithnjë e më pak të përshtatshme (Cunningham, 2003). Kështu, në momentin që këta të rinj arrijnë në adoleshencë, ata shpesh nuk arrijnë të funksionojnë në mjedise kyçe në jetën e tyre, si bashkëmoshatarët prosocialë, shkolla apo vendi i punës.

Duke marrë parasysh ndikimin e karakteristikave individuale, mjedisit dhe ndërveprimeve shoqërore në jetën e përditshme mbi këtë lloj sjelljeje, qëllimi i programit është të monitorojë dhe të balancojë faktorët e rrezikut dhe ata mbrojtës, në mënyrë që ndërhyrja të bëhet në kohë dhe me efikasitet. Studimet (Forgather & deGarmo, 1999) kanë treguar se terapia familjare sjell rezultate pozitive tek fëmijët, por gjatë adoleshencës ndikimi i anëtarëve të rrethit të gjerë familjar merr rëndësi të veçantë. Për këtë arsye, nevojiten programe parandaluese që ofrojnë mbështetje më të gjerë dhe gjithëpërfshirëse.

Vendosja në kujdes rezidencial ose në një formë më të kufizuar të kujdesit është metoda më e zakonshme e trajtimit për fëmijët dhe adoleshentët në rrezik. Megjithatë, ekzistojnë pak studime mbi efektivitetin dhe përfitimet afatshkurtra ose afatgjata të këtyre alternativave perkujdesi pa trajtim shtesë. Ka prova që fëmijët dhe adoleshentët me karakteristika antisociale janë më të vështirë për t'u trajtuar në këto kontekste (Zoccolillo & Rogers, 1991). Përdorimi i kujdesit rezidencial lidhet gjithashtu me shpenzime të konsiderueshme në shëndetin mendor.

Janë kryer disa vlerësime dhe meta-analiza mbi programet efektive. Disa raporte sugjerojnë se shumë lloje të ndryshme ndërhyrjesh mund të jenë efektive për të rinjtë me sjellje shoqërisht të papranueshme. Për të maksimizuar mundësinë e rezultateve pozitive, veçanërisht në rastin e programeve të reja që kanë pak ose aspak të dhëna vlerësimi, është e rëndësishme të merren parasysh elementët e përbashkët dhe konfigurimet që lidhen me efektet më të forta.

Edhe pse këto programe mund të jenë shumë të dobishme, efektiviteti i tyre varet nga disa faktorë, përfshirë:

- Identifikimin e hershëm të të rinjve në rrezik;
- Cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ndërhyrjes;
- Përfshirjen e komunitetit dhe mbështetjen e familjes;
- Fokusin në rehabilitim në vend të ndëshkimit;
- Disponueshmërinë e ndjekjes dhe mbështetjes afatgjatë.

Kur zbatohen në mënyrë efektive, programet parandaluese mund të reduktojnë ndjeshëm përfshirjen e të rinjve në aktivitete kriminale, të nxisin pjesëmarrjen pozitive të tyre në sistemin e drejtësisë, të mbështesin zhvillimin e të rinjve dhe të parandalojnë përfshirjen e tyre në sistemin e drejtësisë penale. Një komponent kyç i suksesit është shkalla në të cilën të rinjtë mund të aplikojnë dhe të përgjithësojnë përfitimet e arritura gjatë trajtimit pas përfundimit të tij.

Faktorët që dhanë rezultate pozitive gjatë ndjekjes së mëvonshme përfshijnë:

- Mbikëqyrje të mirë të të rinjve;
- Moslejimin e kohës së pa mbikëqyrur me bashkëmoshatarë me sjellje shoqërisht të papranueshme;
- Përdorimin e disiplinës së drejtë dhe të qëndrueshme nga prindërit ose kujdestarët.

D. Hogge, Guerra dhe Boxer (2008) argumentojnë se dëshmitë empirikë ngavlerësimet e shumtë të programeve na çojnë të konsiderojmë katër komponentë kyçë të programeve për të rinjtë në konflikt me ligjin:

- Ndërhyrje shumë të strukturuar në vend të programeve jo të strukturuar;
- Ndërhyrje që përfshijnë një komponent kognitiv të lidhur me qëllime specifike;
- Ndërhyrje që angazhojnë familjet dhe reduktojnë rreziqet për sjellje të papranueshme;
- Ndërhyrje më gjithëpërfshirëse që adresojnë faktorë të shumtë rreziku në kontekste të ndryshme.

Programi kërkon një koordinim të vazhdueshëm midis policisë dhe shërbimeve sociale (menaxherëve të rasteve) për vlerësimin e të rinjve në rrezik, si dhe angazhimin e punonjësve rinore dhe këshilluesve individualë, të punësuar bazuar në kontrata shërbimi dhe pjesëmarrje në ekipe multidisiplinare. Bashkëpunimi i vazhdueshëm midis oficerëve të policisë, punonjësve socialë dhe organizatave joqeveritare, i bazuar në një ndarje të qartë të roleve, është thelbësor. Oficerët e policisë kanë përgjegjësinë për vlerësimin, rekrutimin në program, si dhe koordinimin me punonjësit socialë dhe punonjësit rinore; menaxherët e rasteve janë figura kryesore për vlerësimin e rrezikut dhe rekrutimin e të rinjve dhe familjeve, ndërsa punonjësit e rinjve ofrojnë mbështetje për familjet, duke u asistuar nga policia dhe punonjësit socialë. Pjesëmarrja në program është vullnetare dhe plotësisht falas për pjesëmarrësit dhe familjet e tyre. Në kapitujt në vijim do të paraqiten dilemat, argumentet dhe rastet që shpjegojnë arsyet pse programi duhet të ofrohet në mënyrë vullnetare dhe jo të detyrueshme.

2. PARIMET TË PRAKTIKËS

Zbatimi i trajtimit në drejtësinë për të mitur, sipas përkufizimit, kërkon adoptimin e një qasjeje rehabilituese. Kjo do të thotë se një parim bazë i programit është se të miturit që kryejnë vepra penale mund të ndryshojnë dhe të drejtojnë sjelljen e tyre drejt qëllimeve jo kriminale dhe produktive.

- **Parimi i “sa më pranë shtëpisë”:** Sa herë që është e mundur, të rinjtë me sjellje shoqërisht të papranueshme duhet të trajtohen brenda komuniteteve ku jetojnë; burgosja duhet përdorur vetëm si masë e fundit për sigurimin e komunitetit.
- **Parimi i rehabilitimit:** Programet duhet të adresojnë shkaqet themelore të sjelljes, si trauma, përdorimi i substancave, problemet e shëndetit mendor, apo mungesën e arsimimit dhe aftësive. Rehabilitimi synon parandalimin e rikthimit në krim përmes ofrimit të trajtimit, mbështetjes dhe udhëzimit në një mjedis konstruktiv dhe pozitiv, në vend që të fokusohet vetëm në ndëshkim.
- **Parimi i bazuar në prova:** Trajtimi duhet të ndjekë parimet e bazuara në prova për programimin dhe zbatimin; këto programe duhet të jenë të strukturuar dhe të adresojnë faktorët dinamikë të rrezikut, të cilët janë më të prirur për ndryshim dhe për të aplikuar në mënyrë të përgjithshme.
- **Parimi i fokusuar në rrezikun dhe bazuar në forcë:** Programet e trajtimit për të rinjtë me sjellje shoqërisht të papranueshme duhet të adresojnë lloje të ndryshme rreziku për rikthim në krim, dhe niveli i shërbimit duhet të përshtatet kryesisht me profilet specifike të rrezikut të kryerësve. Programi duhet gjithashtu të identifikojë dhe mbështesë forcat e të rinjve si një mekanizëm shtesë për uljen e rrezikut.



3. GRUPI I SYNUAR

Parimi kryesor i programeve parandaluese është njohja dhe ndërhyrja e hershme tek ata që mund të kryejnë krime më shumë një herë. Studimet tregojnë se personat që janë përfshirë në aktivitete kriminale që në moshë të re kanë më shumë mundësi të vazhdojnë një karrierë kriminale më vonë. Për këtë arsye, fëmijët mund të përfshihen në programe parandaluese që nga moshë 8 deri në 15 vjeç. Fëmijët 16 apo 17 vjeç mund të përfshihen nëse vlerësimi tregon që mund të përfitojnë nga programi.

Kriteri kryesor është që fëmijët të kenë bërë të paktën një vepër kriminale gjatë 12 muajve të fundit. Gjithashtu, duhet të jenë të pranishëm disa faktorë rreziku. Vlerësimi i rrezikut ndihmon për të përcaktuar sa i madh është rreziku i sjelljes kriminale dhe shërben për të përzgjedhur pjesëmarrësit. Vendimin për pranimin në program e marrin së bashku menaxheri i rastit nga shërbimet sociale dhe polici. Ata gjithashtu kontrollojnë nëse faktorët e rrezikut në jetën e fëmijës janë të njohur nga policia ose shërbimet sociale.

Në program përshkruhet sjellja që kërkon referim dhe arsyet pse referohet personi dokumentohen. Këto mund të jenë, për shembull, sjellje agresive fizike ndaj bashkëmoshatarëve në komunitet, fyerje ndaj mësuesve në shkollë, paralajmërime të shumta gjatë viteve shkollore, shitje ose përdorim droge, përplasje të shumta dhe të ngjashme.

4. VLERËSIMI - RREZIKU DHE FAKTORËT MBROJTËS

Disa faktorë të zakonshëm rreziku për delinkuencën tek të miturit përfshijnë:

- neglizhencë ose abuzim në mjedisin familjar ;
- mungesa e monitorimit dhe udhëzimit të duhur nga prindërit ose kujdestarët;
- familje me një prind;
- shoqërimi me bashkëmoshatarë me sjellje shoqërisht të papranueshme ;
- varfëria dhe papunësia ;
- mungesa e aksesit në arsim cilësor
- lagje/komunitete me nivel krimi të lartë,
- mungesa e kohezionit social,
- pranimit shoqëror i dhunës ose sjelljes kriminale
- disa faktorë psikologjikë, siç janë problemet e shëndetit mendor të patrajuara, përdorimi i substancave etj.

Në drejtësinë për të mitur, mjetet e vlerësimit të riskut përdoren për të vlerësuar mundësinë që një i mitur të përfshihet në sjellje kriminale ose të përfshihet në sistemin e drejtësisë. Këto mjete ndihmojnë në orientimin e vendimeve në lidhje me ndërhyrjen, rehabilitimin dhe shmangien e përgjegjësisë, duke siguruar që burimet t'u ndahen atyre që janë më në rrezik.

Disa mjete të përdorura zakonisht për vlerësimin e rrezikut të delinkuencës tek të miturit janë Inventari i Nivelit të Shërbimit/

Menaxhimit të Rastit për të Rinj (YLS/CMI), një mjet i përdorur gjerësisht për vlerësimin e rrezikut dhe nevojave, i projektuar për të vlerësuar mundësinë e rikthimit të veprave penale tek të miturit. Ai bazohet në kërkime që identifikojnë faktorët që kontribuojnë në delinkuencë dhe përdoret për të udhëhequr vendimet në lidhje me dënimin, mbikëqyrjen dhe rehabilitimin. Faktorët e vlerësuar janë:

- historia e sjelljes antisociale;
- marrëdhëniet familjare dhe prindërore;
- presioni i bashkëmohatarëve;
- sjellja në shkollë dhe në punë;
- përdorimi i substancave dhe problemet e shëndetit mendor;
- qëndrime dhe vlera (p.sh., agresion, përdorim substancash).

Mjete të tilla ofrojnë një vlerësim gjithëpërfshirës të rrezikut dhe ndihmojnë në krijimin e një plani individual të menaxhimit të rasteve. Shumë mjete bëjnë dallimin midis faktorëve statikë (historia e mëparshme kriminale) dhe faktorëve dinamikë (mjedisi familjar, ndikimi i bashkëmohatarëve), ku këta të fundit janë më të ndryshueshëm dhe më të ndjeshëm ndaj ndërhyrjes. Rivlerësimet e rregullta janë kritike, pasi niveli i rrezikut të një të riu mund të ndryshojë me kalimin e kohës bazuar në sjelljen, mjedisin dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të tij.

Parimi i rrezikut në klasifikimin e rasteve përcakton që rastet me rrezik të lartë duhet të përfitojnë nga nivele intensive shërbimesh, ndërsa rastet me rrezik më të ulët mund të marrin nivele më të ulëta (Andrews, Bonita, & Hoge, 1990). Respektimi i këtij parimi na ndihmon të përqendrojmë burimet tona tek rastet që kanë nevojë të vërtetë për ndërhyrje dhe, për më tepër, na inkurajon të shmangim përfshirjen e tepërt në jetën e të rinjve me rrezik më të ulët.

Në programin tonë, punonjësit socialë dhe oficerët e policisë trajnohen përmes programit paraprak për të vlerësuar rrezikun duke përdorur këto koncepte kryesore:

- Sigurohet një pikë e vetme hyrjeje për të gjithë të miturit që hasin sistemin e drejtësisë për të miturit.
- Ofron një vlerësim të menjëhershëm dhe gjithëpërfshirës, që mund të përfshijë një proces fillestar skanimi dhe më pas një vlerësim më intensiv për ata që identifikohen si me rrezik dhe nevojë të moderuar ose të lartë.
- Të rinjtë e vlerësuar si me rrezik të moderuar ose të lartë dërgohen më tej në program.

Qëllimi kryesor i vlerësimit është përfshirja e të rinjve në program, por gjithashtu edhe kuptimi i lidhjes midis problemeve dhe kontekstit më të gjerë ku jetojnë të rinjtë dhe familjet e tyre. Gjithashtu, nevojitet të vlerësohen pikat e forta dhe nevojat e të rinjve dhe familjeve të tyre.



5. PJESEMARRËSIT

5.1. OFICERËT E POLICISË – KUALIFIKIMET DHE DETYRAT

Ndërkohë që shërbimet sociale janë figurat kryesore për vlerësimin e rrezikut dhe menaxhimin e rasteve, oficerët e policisë janë të parët që ndërveprojnë me të miturit që përfshihen ose janë në rrezik të përfshirjes në sjellje kriminale. Ata identifikojnë shenjat paralajmëruese në faza të hershme dhe i referojnë të rinjtë në rrezik pranë shërbimeve sociale. Megjithatë, për të arritur rezultate më të mira, është thelbësore që policia dhe shërbimet sociale të veprojnë në mënyrë të koordinuar.

Policia referon të miturit tek punonjësit socialë pas ndërveprimeve me ligjin dhe mund të ndërtojë marrëdhënie pozitive me të rinjtë në komunitet. Gjithsesi, ajo shmang marrjen e rolit rehabilitues dhe fokusohet tek parandalimi i krimit dhe zbatimi i ligjit, ndërsa ndërhyrjet më të detajuara i planifikon dhe zbaton shërbimi social. Rolet e secilit janë të përcaktuara qartë.

Në kuadër të programit tonë, oficerët e policisë janë inspektorë ose detektivë me përvojë të gjerë në punën me të rinjtë që shfaqin sjellje shoqërisht të papranueshme. Sa herë që është e mundur, ata punojnë me kohë të plotë me këtë kategori të rinjsh, megjithëse zbatimi lokal i programit mbetet përgjegjësi e autoriteteve përkatëse.

Detyrat e tyre përfshijnë:

- ➡ vlerësimin dhe referimin tek shërbimet sociale;
- ➡ skanimin e rrezikut;
- ➡ përzgjedhjen për përfshirje në program, së bashku me punonjësit socialë, të të rinjve me rrezik të moderuar dhe të lartë;
- ➡ monitorimin e brendshëm dhe hartimin e raporteve;

- ➔ pjesëmarrjen në takime të rregullta;
- ➔ shkëmbimin e vazhdueshëm të informacionit me anëtarët e tjerë të ekipit;

Kur ndërveprojnë me të rinjtë që shfaqin sjellje të papranueshme shoqërore, oficerët e policisë trajnohen të jenë të ndjeshëm dhe mirëkuptues, duke njohur ndryshimet zhvillimore midis të miturve dhe të rriturve. Qasja e tyre shmang masat ndëshkuese dhe fokusohet në praktikat riparuese që nxisin rritjen personale dhe ndjenjën e përgjegjësisë

5.2. PUNONJËS SOCIALË – MENAXHERË RASTESH – KUALIFIKIME DHE DETYRA

Punonjësit socialë që punojnë në shërbimet sociale në tre vendet tona luajnë një rol vendimtar në:

- ✓ vlerësimin e nevojave të të rinjve me sjellje shoqërisht të papranueshme,
- ✓ kryerja e vizitave në shtëpi,
- ✓ duke u dhënë rekomandime gjykatave.

Shërbimet sociale kanë ekspertizën në ofrimin e mbështetjes rehabilituese, edukative dhe terapeutike për të rinjtë.

Ne kemi theksuar tashmë se policia mund të luajë një rol mbështetës duke identifikuar të rinjtë në rrezik, duke ndërtuar besim dhe duke i referuar ata te shërbimet sociale, por ata nuk duhet të jenë ofruesit kryesorë të programeve parandaluese, pasi fokusi i tyre është përgjithësisht në

zbatimin e ligjit dhe sigurinë publike. Një qasje bashkëpunuese midis dy sektorëve mund të maksimizojë efektivitetin e programit.

Pas referimit nga policia, menaxheri i rastit bën shqyrtimin e riskut duke bërë një vizitë në shtëpi i shoqëruar nga oficeri/inspektori i policisë.

Nëse vlerësimi i rrezikut nga oficeri i policisë dhe menaxheri i rastit është i njëjtë ose dukshëm i ngjashëm, i riu referohet në program.

Pasi i riu të futet në program, detyra është:

- ✓ komunikim me anëtarët e tjerë të ekipit, sa herë që është e nevojshme, veçanërisht me punonjësin rinor,
- ✓ pjesëmarrja në takimin e pranimit dhe takimin përfundimtar,
- ✓ pjesëmarrja në takime konsultative,
- ✓ konsultime të vazhdueshme me familjet,
- ✓ duke shkuar në vizita në shtëpi së bashku me anëtarët e tjerë të ekipit sa herë që është e nevojshme,
- ✓ vlerësimin e procesit përmes planifikimit dhe menaxhimit të rasteve dhe ofrimin e masave shtesë sa herë që është e nevojshme,
- ✓ duke qenë një pjesë e rëndësishme në planet e tranzicionit, ndjekjen dhe shërbimet e mëtejshme të planifikuara për të rinjtë dhe familjen.

Menaxheri i rastit shërben si mbështetje shtesë për të rinjtë, familjen, punonjësin rinor dhe motivon më tej familjet dhe të rinjtë që të angazhohen në shërbime dhe programe pranadaluëse dhe rehabilituese.

5.3. KËSHILLUES – KUALIFIKIME DHE DETYRA

Studimet tregojnë se këshillimi individual mund të mos jetë efektiv vetëm, por është një komponent i rëndësishëm i programeve më të strukturuar dhe rrit gjasat e suksesit. Këshillimi i kombinuar me menaxhimin intensiv të rasteve rrit gjasat e efektivitetit (Lee & McGinnis-Haynes, 1978; Shore & Massimo, 1973). Këshillimi individual duke përdorur profesionistë të shëndetit mendor si pjesë e programeve të tjera më të strukturuar gjithashtu ka treguar rrezultate pozitive, veçanërisht në mjedise jo - institucionale (Linsey & Wilson, 1998).

Ky program është planifikuar të ndihmojë një këshilltar/trajner aftësish individuale të ofroje shërbim për secilin të ri dhe veçanërisht në raste sfiduese.

Detyrat e tyre përfshijnë:



Terapia/këshillimi individual nuk është fokusi qendror në trajtim, por roli i saj kryesor është të ndihmojë të rinjtë të mësojnë aftësitë e nevojshme për t'u përshtatur dhe për t'u lidhur me sukses me të rriturit dhe bashkëmoshatarët.



Këshilltarët individualë kanë takime të paktën një herë në javë me të rinjtë dhe mund të kenë kontakte më të shpeshta telefonike.



Këshilltarët individualë e mbajnë menaxherin e programit të informuar për aktivitetet që zhvillohen me të riun dhe familjen. Komunikimi është i nevojshëm edhe me familjen/kujdestarët ligjorë të të riut, punonjësit e të rinjve dhe menaxheret e rasteve.



Këshilltari individual identifikon fushat për të punuar me të rinjtë, duke i formuluar situatat në një mënyrë neutrale dhe duke i ndihmuar të rinjtë të mësojnë dhe praktikojnë më shumë aftësi adaptive që ai/ajo mund t'i praktikojë në shtëpi ose me bashkëmoshatarët. Në muajt e parë të programit, kjo marrëdhënie mund të përdoret në mënyrë strategjike për të "stabilizuar të rinjtë" (Cunningham, 2003), veçanërisht ata në nevojë ose rrezik të lartë.

Këshilltarët individualë janë të trajnuar në psikologji, punë sociale ose profesione të ngjashme. Përveç punonjësve të të rinjve, ata ofrohen nga organizatat e mirëqenies së të rinjve ose nga institucionet publike. Ne mendojmë se kjo pjesë e programit është me rëndësi të madhe pasi shumë të rinj me sjellje të papranueshme shoqërisht kanë probleme themelore të shëndetit mendor si depresioni, ankthi, PTSD ose çrregullime të sjelljes, të cilat mund të kontribuojnë në sjelljen e tyre kriminale. Gjithashtu, ata shpesh vijnë nga sfonde abuzimi, neglizhence ose ekspozimi ndaj dhunës. Këshillimi mund t'i ndihmojë ata të përpunojnë këto përvoja traumatike dhe të zhvillojnë mekanizma përballimi, si dhe të zhvillojnë aftësi më të mira sociale dhe emocionale, të tilla si empatia, kontrolli i impulseve dhe zgjidhja e konflikteve. Këto aftësi mund të çojnë në vendimmarrje të përmirësuar dhe të zvogëlojnë gjasat e sjelljes kriminale në të ardhmen. Ky këshillim gjithashtu mund të përmirësojë komunikimin familjar dhe ofron përfitime afatgjata në aspektin e shëndetit emocional, integritetit social dhe zvogëlimin të gjasave të përsëritjes së veprës penale.

5.4. DETYRAT DHE KUALIFIKIMET E PUNONJESVE

RINORE/FAMILJARE

Punonjësit e të rinjve dhe të familjes angazhohen në bazë të një kontrate shërbimi e cila përfshin specifikimet, detyrat dhe kërkesat e sakta që i vendosen punonjësit të të rinjve. Ata punësohen nga një OJQ e pavarur dhe duhet të kenë njohuri në pedagogji, pedagogji speciale, punë sociale, psikologji ose fusha të ngjashme. Ata gjithashtu duhet të kenë një përvojë të konsiderueshme në trajtimin e të rinjve në rrezik.

Detyrat e tyre përfshijnë:

- vendosja e kontakteve me të rinjtë dhe familjet;
- vizita javore në shtëpi;
- punë në terren;
- keshillim;
- këshilla dhe mbështetje për kujdestarët dhe ndërhyrjet familjare;
- pjesëmarrja ne workshope dhe takime;
- përmbushja e kontratës,
- shkrimet e raporteve;
- shkëmbim ekspertësh me shkollat, shërbimet sociale, bashkëpunim me palët e interesuara;
- hartimin e planeve individuale, edukative dhe të parandalimit të krimit për pjesëmarrësit.

Numri mesatar i pjesëmarrësve për çdo punonjës rinor në program është dhjetë familje.

Ja pse mendojmë se OJQ-të duhet ta kryejnë këtë pjesë të programit:

Një analizë tregoi se shërbimet sociale në Serbi, Shqipëri dhe Mal të Zi, ndër vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, kanë mungesë serioze të kapaciteteve, nuk kanë stafin e nevojshëm për të ofruar shërbime me cilësi të përshtatshme për numrin në rritje të njerëzve në nevojë. Rekomandimi është që qeveritë “të angazhohen në një bashkëpunim më të lartë me OJQ-të që ofrojnë shërbime sociale dhe të ngrene modele bashkëpunimi.

5.5. STAF MJEKËSOR

Koordinimi midis ofruesve të kujdesit shëndetësor të sistemit të drejtësisë për të mitur dhe ofruesve të shërbimeve të komunitetit nuk është përcaktuar qartë në ligje dhe protokolle, megjithëse është thelbësor. Roli i pediatërve dhe specialistëve të tjerë duhet të jetë thelbësor në njohjen e rreziqeve, por edhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit midis komunitetit dhe sistemeve të tjera.

Të rinjtë në konflikt me ligjin janë një popullatë me rrezik të lartë dhe në shumë raste ata janë të privuar në shumë fusha, duke përfshirë nevojat fizike, zhvillimore dhe të shëndetit mendor. Shumë prej tyre kanë pasur kujdes shëndetësor jo të qëndrueshëm ose inekzistent . Nevojat shëndetësore të këtyre të rinjve identifikohen zakonisht kur ata pranohen në një qendër paraburgimi për të mitur ose akuzohen ligjërisht. Studime të shumta tregojnë se disa probleme shëndetësore ndodhin tek adoleshentet në shkallë më të lartë sesa në popullatën e përgjithshme. Ato grupe fëmijësh/të rinjsh janë në rrezik më të madh për të pasur probleme me shëndetin mendor. Ata mund të kenë një rrezik më të lartë të abuzimit me substanca , traumës dhe çrregullimeve të patrajuara të shëndetit mendor, siç janë depresioni, ankthi ose çrregullimet e sjelljes. Për

shembull, prevalenca e çrregullimeve mendore midis të paraburgosurve të mitur vlerësohet të jetë deri në 60 përqind dhe raportet sugjerojnë se adoleshentët që janë të paraburgosur kanë një rrezik tre deri në katërfish të vetëvrasjes. Por më shumë se kjo, adoleshentët shpesh pranohen në spitale për lëndime të lehta ose aksidente që në fakt ndodhin në kontekstin e problemeve të rënda të sjelljes dhe stresit familjar¹. Sëmundjet ngjitëse, infeksionet seksualisht të transmetueshme, hepatiti, lëndimet dhe problemet ortopedike, çrregullimet gastrointestinale dhe shqetësimet dermatologjike gjithashtu i prekin këta të rinj, si dhe shtatzënitë e hershme dhe abortet. Nga ana tjetër, nuk ka vazhdimësi të kujdesit shëndetësor. Punonjësit mjekësorë duhet të trajnohen për të njohur dhe adresuar këto shqetësime. Departamentet dhe klinikat e shëndetit publik duhet të kenë marrëveshje për të marrë përgjegjësinë për kujdesin e këtyre të rinjve. Qëllimi ynë i parë është t'i trajnojmë këta profesionistë që të njohin reagimet dhe njohuritë e tyre për të rinjtë në konflikt me ligjin. Pa njohuri të mjaftueshme, profesionistët mund të supozojnë se të rinjtë janë të vështirë dhe të pakëndshëm, dhe nuk arrijnë të njohin rreziqet. Me trajnim dhe njohuri të mjaftueshme, mund të ketë gjithashtu mundësi për të advokuar për rehabilitim terapeutik në vend të një fokusi të vetëm institucional në ndëshkim².

Mjetet e shqyrtimit dhe vlerësimit të bazuara në prova duhet të përdoren universalisht në spitale për të identifikuar të rinjtë me nevoja të shëndetit mendor dhe të tjera. Duket se edukimi i stafit mjekësor rreth problemeve të shëndetit mendor, sjelljes dhe ato ligjore të të rinjve, ka të ngjarë të përmirësojë gjithashtu aftësinë e sistemit për të identifikuar dhe për t'iu përgjigjur në mënyrë të përshtatshme nevojave të tilla. Hulumtimet³ tregojnë se nevojat e shëndetit mendor të këtyre të rinjve duhet të bëhen "përgjegjësi kolektive e komunitetit", bazuar në bashkëpunimin me komunitetin e gjerë për të përmbushur nevojat e të rinjve që perfishohen në konflikt me ligjin dhe kanë çrregullime të shëndetit mendor.

1 <https://psychiatryonline.org/doi/10.1176/appi.ps.54.1.107>

2 <https://journalofethics.ama-assn.org/article/health-care-incarcerated-adolescents-significant-needs-considerable-obstacles/2005-03>

3 <https://pmc.ncbi.nlm.nih.gov/articles/PMC4772248/#sec6-ijerph-13-00228>

